



**VENDIM**

**Nr. 138, Datë 26.11.2015**

**PËR  
LICENSIMIN E SHOQËRISË “HP UJANIKU ENERGY” SH.P.K. NË  
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA  
HEC “UJANIK 2” ME FUQI TË INSTALUAR 2500 KW**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “a” dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; 13 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve ERE-s, Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HP Ujaniku Energy” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie nga Hec “Ujanik 2”,

**Konstatohet se :**

Aplikimi i shoqërisë “HP Ujaniku Energy” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni tekniko- ekonomik (neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3; 4.1.4; 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të licensojë shoqërinë “HP Ujaniku Energy” sh.p.k., ne aktivitetin e prodhimit te energjisë elektrike nga Hec“Ujaniku 2” me fuqi të instaluar 2500 KW.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Petrit AHMETI**